

VENDIM
Nr.577, datë 28.5.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË BASHKISË VORË TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Vorë të qarkut të Tiranës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 74 (shtatëdhjetë e katër) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 448 (katërqind e dyzet e tetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Vorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Vorë

Lidhja nr.1

Numri rendor i pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
2-13,447,448	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
14-17	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore	Në pronësi
18,37,125-129	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
20-30	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
38-54	Shërbime funerale	Në pronësi
19	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
56,59-124	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës (troje)	Në përdorim
55,57,58,130-194	Infrastrukturë (rrugore vendore, lulishte, trotuar)	Në pronësi
226-242	Prona të mbrojtjes kombëtare	Në pronësi
377,379,381,383,385, 387,388,392,395,413, 417-421,429-443	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive, kanale të treta	Në pronësi
374,375,376,378,380, 382,384,386,389,390, 391,393,394	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim